



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNEN E NOVOBËRDËS  
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Novobërdës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Mirlinda Beqiri-Udhëheqës* ekipi, *Ejup Simnica*, *Besim Lezi* dhe *Elvir Krasniqi* Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Luljeta Morina*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	12
4 Qeverisja e mirë.....	30
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	32
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	38
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	41

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Novobërdës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 27/09/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Novobërdës.

### Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, përveç mbivlerësimit material të buxhetit për të hyrat prej 100,000€. Gjithashtu, ne nuk ofrojmë siguri se shpenzimet e pagave paraqesin pamje të vërtetë, pasi nuk na janë ofruar dëshmi për vijueshmërinë në punë, për disa punëtorë të arsimit.

#### Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

Gjendja e pasurive, llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve nuk ishte prezantuar drejtë në pasqyrat financiare vjetore. Gjithashtu, mungonin shpalosjet për detyrime kontigjente dhe avancet e hapura, të pa arsyetuara.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunes gjatë procesit të auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Novobërdës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### Baza për opinion të kualifikuar

Prezantimi i PFV ishte përcjell me dobësi si në vijim:

- Neni 14. Raporti i ekzekutimit të buxhetit, hyrja e parasë se gatshme në llogari të thesarit të hyrat jo tatimore si buxhet ishin mbivlerësuar materialisht për 100,000€, ndërsa edhe realizimi i tyre ishte mbi vlerësuar për 1,000€;
- Neni 14. Raporti i ekzekutimit të buxhetit, buxheti final i granteve të përcaktuara të donatorëve, ishte prezantuar gabimisht në vlerën 34,285€ apo 5,788€ më pak, ndërsa realizimi i garantëve ishte mbivlerësuar për 13,007€; dhe

- Nga 20 rastet e audituar në drejtorinë e arsimit, në 14 prej tyre nuk na është ofruar dëshmi për vijueshmërinë në punë, me ç'rast ishte e pamundur të konfirmohet që mësimmësuesit kanë punuar gjatë vitit 2018. Paga bruto për këta punëtorë gjatë kësaj periudhe ishte 43,393€. Për më shumë, kjo e gjetur trajtohet te çështja A7.

Arsyeja për këto gabime është mungesa e kompetencës profesionale të zyrtarëve të angazhuar me këtë përgjegjësi, edhe pse komuna e arsyeton, si gabim teknik.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

### Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se

- Neni 16, Shpalosjet e Llogarive e Arketueshme, Komuna nuk ka paraqitur fare saldo të llogarive të arkëtueshme nga qiratë, duke i nënvlerësuar ato në vlerë prej 11,965€;
- Neni 17, Raporti për detyrimet e pa paguara, nuk ishte i plotë, duke mos përfshirë nëntë pagesa në vlerë 11,374€. Këto pagesa ishin ekzekutuar në muajt e parë të vitit 2019. Me ç'rast detyrimet kontingjente janë nënvlerësuar për 9,877€ (të cilat në PFV ishin prezantuar me vlerë zero) dhe obligimet e pa paguara në vlerë 1,497€;
- Neni 19, Pasuria kapitale ishte nënvlerësuar për shkak të pasurive të pa regjistruara ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet ishin shpalosur me zero. Nga 22 pagesat e audituar për investime kapitale, (pasuri të përfituara në shumën prej 217,016€), janë regjistruar vetëm pesë pagesa në shumë prej 104,448€. Shuma e paregjistruar për investime kapitale është 102,659€<sup>1</sup>. Kjo ka ndodhur në mungesë të një komunikimi/ bashkëpunimi të mirëfilltë zyrtar në mes të njësisë së financave dhe zyrtarit të pasurisë; dhe
- Neni 20, Raportet për avancet e pa arsyetuara, nuk ishte shpalosur avanci i pa mbyllur në vlerë 2,581€.

Arsyeja për këto gabime është mungesa e kompetencës profesionale të zyrtarëve të angazhuar me këtë përgjegjësi. Opinioni ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këto çështje.

<sup>1</sup> Duke përjashtuar pagesat e identifikuar si keq klasifikime.



## **Çështjet kyçe të auditimit**

Përveç çështjeve të përshkruara në bazën për opinion të kualifikuar, konkludojmë se nuk ka çështje kyçe të auditimit për t'u komunikuar.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Kryetari i Komunës së Novobërdës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Ligji për financat e pushtetit lokal Nr. 05/L -108 dhe plotësim ndryshimi Nr. 03/L-049;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike dhe 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë;
- Ligji i buxhetit për vitin 2018 numër 06/L-020;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të AB-së dhe ZKA-së nga KK;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet mujore dhe tremujore, raportet operative (të performancës); dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Lidhur me PFV-ve, përveç çështjeve të përmendur te baza për opinion dhe theksimit të çështjes, kemi identifikuar edhe mos-pajtueshmëri si në vijim:

- Shënimi 4 - Shpenzimet komunale, buxheti final është nënvlerësuar për 1,000€;
- Neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, te ndryshimet dhe ndarja finale e buxhetit sipas SIMFK - hyrjet, komuna nuk kishte paraqitur asnjë përshtatjet buxhetore që lejohet gjatë vitit. Ndryshimit final i buxhetit nuk ishte i saktë në vlerë <sup>2</sup> prej 21,000€;

---

<sup>2</sup> Komuna kishte një shkurtim buxhetor nga garanti qeveritar te kategoria e pagave në vlerë 32,164€; ndërsa kategoritë tjera të shpenzimeve buxheti ishte rritur për 97,396€ për shkak të bartjes së të hyrave, donacioneve dhe rritjes së fondit të huamarrjes. Ndryshimet në buxhetin final duhet të jenë prej 65,232€.

- Neni 21 – raporti për të hyrat vetjake të pa shpenzuar komuna kishte shpalosur gabimisht shumën e mbetur për bartje në vitin 2019 në vlerë 40,000€ e jo 65,409€ duke i nënvlerësuar të hyrat e pa shpenzuara për 25,409€;
- Neni 25 – Raporti për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave, komuna kishte shpalosur 363 të punësuar, bazuar në listën e pagave të muajit dhjetor figuronin 382<sup>3</sup> punëtor. Komuna kishte nënvlerësuar numrin e punëtorëve me orar të plotë për 19 të punësuar gjithashtu, mungonin periudhat krahasuese për dy (2) vitet paraprake; dhe
- Neni 26- raporti për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave ishin shpalosur gabimisht personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, ndërsa neni 27 që kërkon një shpalosje e tillë ka mbetur i zbrazet.

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e PFV-ve është menaxhuar në mënyrë të dobët.

#### DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale të theksuar te opinioni i auditimit dhe çështje tjera si shpalosjet të cilat kanë ndikuar në theksimin e çështjes.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë si në vijim:

- Komuna nuk kishte raportuar progresin e arritur të investimeve kapitale sipas nenit 17.4 i ligjit të buxhetit Nr. 06/L-020 i cili kërkon që Zyrtari kryesor financiar i secilës komunë i dorëzon Kryetarit të Komunës brenda tre (3) javëve nga mbyllja e secilit tre (3) mujor një raport të detajuar për progresin e arritur në zbatimin e të gjitha projekteve kapitale me vlerë më të lartë se dhjetë mijë (10,000) euro. Një kopje e raportit të tillë duhet t'i dorëzohet edhe Ministrit të Financave.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikimin e opinionit dhe Theksimit të çështjes, në këtë raport. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet për të siguruar se të gjitha shënimet në PFV prezantohen në përpunje me kërkesat e rregullores së MF-së për Raportimin vjetor financiar. Po ashtu, kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë komunale (janë të evidentuara në regjistrat e pasurisë) dhe llogarit e arkëtueshme, obligimet janë shpalosur drejtë në PFV-të .

<sup>3</sup> Komuna në listën e pagave ka të evidentuar 299 të punësuar me orar të plotë, 1 me zero, dhe 82 me orar jo të plotë.

Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi planifikimi, realizimin e buxhetit, të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit dhe klasifikimi i duhur i shpenzimeve. Kontrollet duhet të jen funksionale me qëllim që të eliminohen parregullsitë edhe në fushën e të hyrave sidomos të tatimit në pronë, nga qiratë dhe dhënia e lejeve të ndërtimit. Aktivitetet shtesë duhet të ndërmerren edhe me rastin e planifikimit, kontraktimit dhe ekzekutimit të shpenzimeve me prokurim. Gjithashtu, rendësi e veçantë duhet ti kushtetohet edhe menaxhimit të personelit, procesit të rekrutimit dhe pagesave të bazuar në vijueshmërinë në punë të stafit të angazhuar. Menaxhimin i pasurisë, obligimeve, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme kërkon aplikimin e veprimeve shtesë apo mekanizmave adekuat nga ana e menaxhmentit.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>4</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>2,660,394</b>	<b>2,725,625</b>	<b>2,546,027</b>	<b>2,342,124</b>	<b>2,098,485</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	2,400,428	2,368,264	2,348,959	2,114,032	1,810,180

<sup>4</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Të bartura nga viti paraprak <sup>5</sup>	-	46,181	24,017	40,564	61,903
Të hyrat vetjake <sup>6</sup>	238,319	238,318	149,007	159,618	203,847
Financimi nga Huamarrja	21,647	32,790	2,793	-	-
Donacionet e brendshme	-	18,221	-	15,266	3,928
Donacionet e jashtme	-	21,851	21,251	12,644	18,627

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 65,231€. Ky ndryshim ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak prej 46,180€, donacioneve të brendshme në vlerë 18,221€, donacioneve të jashtme 21,851€, rritjes së financimit nga fondi i huamarrjes prej 11,143€, si dhe shkurtimi prej 32,164€ për paga sipas autorizimeve të MF.

Në vitin 2018, OB ka shpenzuar 93% të buxhetit final ose 2,546,027€, apo 4% me pak krahasuar me vitin 2017. Megjithatë, realizimi i buxhetit ka disa mangësi të shpjeguara më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>2,660,394</b>	<b>2,725,625</b>	<b>2,546,027</b>	<b>2,342,124</b>	<b>2,098,485</b>
Pagat dhe Mëditjet	1,889,443	1,857,279	1,857,279	1,767,008	1,740,370
Mallrat dhe Shërbimet	235,017	251,348	216,752	152,556	161,882
Shërbimet komunale	46,000	46,510	46,456	47,001	55,456
Subvencionet dhe Transferet	9,521	10,063	10,058	10,670	11,355
Investimet Kapitale	480,413	560,425	415,482	364,888	129,422

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit prej 80,012€ për investime kapitale, vetëm 74% e buxhetit ishte ekzekutuar. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe disa projekte të reja për vitin aktual;
- Buxhetit për paga dhe mëditje ishte shkurtuar për 32,164€, ndërsa për mallra dhe shërbime ishte rritur për 16,331€. Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime përfshin gjithashtu të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm prej 9,645€ si dhe nga financimi përmes huamarrjes prej 6,686€;

<sup>5</sup> Të hyrat vetjake të komunës të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>6</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

- Komuna e Novobërdës ka pranuar grante nga donatorët vendorë në vlerë 18,221€, të cilat ishin alokuar për projektin e subvencionimit të fermerëve me mekanizma bujqësorë. Ndërkohë që buxheti nuk ishte realizuar fare, ku projekti ishte realizuar nga fondi i grandit të përgjithshëm (fondi 10);
- Gjithashtu, komuna ishte përfituese e një grandit tjetër nga Qeveria Zvicerane për projektin “Ngritja e performances në shkolla” në shumën prej 21,851€ i cili ishte realizuar 97%;
- Në buxhetin fillestar komuna kishte mjete financimi nga huamarrja në vlerë 21,647€, ndërsa në buxhetin final shuma ishte rritur në 32,790€. Komuna nuk kishte njohuri për këto mjete të shtuara ndërsa realizimi i sajë ishte i ultë për faktin që projektet ishin bartur për vitin vijues.

## Rekomandimet

### Çështja A1<sup>7</sup> - Shpenzimi i ulët i buxhetit për Investime Kapitale

**Gjetja** Shkalla e ekzekutimit të buxhetit për investimet kapitale është sfida kryesore me të cilën përballlet komuna. Përqindja më e madhe e shpenzimeve është koncentruar në muajin dhjetor (rreth 31% e realizimit), dhe po ashtu vetëm 74% e buxhetit të kësaj kategorie është shpenzuar. Kjo ishte rezultat i planifikimit jo të mirë të shpenzimeve në këtë kategori.

**Rreziku** Ekzekutimi i ulët i buxhetit tek investimet kapitale do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion. Për komunën mos-përmbushja e programit për investimet kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve në dobi të qytetarëve të cilat ndikojnë edhe në mirëqenien e tyre si taksapagues.

**Rekomandimi A1** Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2018 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitet e ardhshme. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

<sup>7</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja.

Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura.

Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

---

## Çështja A2 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori jo adekuate

### Gjetja

Gjatë vitit 2018, komuna ka paguar, regjistruar keq klasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 16,228€, si pasojë e mos planifikimit të duhur të buxhetit duke shkaktuar mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive ekonomike dhe prezentim jo të drejtë të tyre. Shpenzimet e evidentuara nuk ishin në përputhje me nenin 18.2.4 i rregullores 01/2013/MF për shpenzimin e parasë publike planin kontabël dhe udhëzimin administrativ UA 2005/08 që përcakton klasifikimin e drejtë të shpenzimeve, dhe kemi identifikuar se:

- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve keq klasifikimi arrin vlerën 6,320€; prej tyre 4,320€ ishin shpenzuar për Furnizim me lopë, shpenzime këto që takojnë shpenzimeve për investimet kapitale -Tranfere kapitale për entitete jo publike, ndërsa pagesa prej 2,000€ për Subvencionimin e OJQ për realizimin e projektit “Ndiqja e të diplomuarve nga komuniteti pakicë për t’u kyçur në administratën publike në nivel qendror dhe lokal, në Kosovë” i takonin shpenzimeve për subvencione për entitetet publike;
- Nga kategoria e investimeve kapitale vlera e keq klasifikimit arrijnë shumën 9,908€, prej tyre 6,973€ janë ekzekutuar në emër të pagave bazuar në vendime gjyqësore, ndërsa 2,935€ janë shpenzime për mallra dhe shërbime për projektin-Gëlqerosja e Shkollave dhe Ambulantave në KK Novobërdë.

### Rreziku

Klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve jep informata të gabueshme për shfrytëzuesit dhe për vendimmarrësin. Gjithashtu, pagesat e tilla rezultojnë me shpenzim shtesë dhe rrisin rrezikun e arritjes së objektivave të përcaktuara.

**Rekomandimi A2** Kryetari të siguroj se janë ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për të planifikuar buxhet të mjaftueshëm krahas detyrimeve/obligimeve që pret komuna të përballet, për të ju dhënë prioritet shlyerjes së këtyre obligimeve me kohë, si dhe të prezantojë drejtë shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe natyrës reale të shpenzimeve.



### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna e Novobërdës në 2018 ishin në vlerë 165,823€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	238,319	238,319	165,823	192,030	237,259
<b>Totali</b>	<b>238,319</b>	<b>238,319</b>	<b>165,823</b>	<b>192,030</b>	<b>237,259</b>

Përpos të hyrave të prezantuara në tabelë, komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë 26,429€, (17,495€ janë nga dënimet e policisë, 3,490€ gjobat e gjykatave si dhe 5,444€ nga agjencia e pyjeve).

Të hyrat vetjake prej 173,024€ janë shpenzuar për nevojat e komunës, kurse pjesa e mbetur e të hyrave të arkëtuara në vlerë 65,409 € janë transferuar për tu shpenzuar në vitin 2019.

#### Rekomandimet

#### Çështja A3 - Mos respektimi i procedurave ligjore gjatë lëshimit të lejeve ndërtimore

**Gjetja** Komuna ka lëshuar leje ndërtimore duke mos i përfillur procedurat e parapara sipas Ligjit për Ndërtimit numër 04/L-110.

Në katër (4) rastet e audituara komuna nuk kishte lëshuar vërtetim për pranimin e kërkesës së aplikuesit, kërkesë e nenit 20.2 e Ligjit të Ndërtimit i cili parasheh që me rastin e kërkesës për leje ndërtimore, organi kompetent do të lëshoj vërtetim për pranimin e kërkesës së aplikuesit. Gjithashtu aplikacionet e palëve nuk ishin protokolluar apo nënshkruar me çka nuk mund të dëshmohet data e pranimit të kërkesës për leje ndërtimore.

Sipas nenit 20.3.2 të Ligjit për ndërtimi, kërkesës për leje ndërtimore i bashkëngjitet edhe akti ligjor administrativ për vendosjen e kushteve ndërtimore. Në tri raste, kërkesat e pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimore (objekte jo për banim) nuk e kishin të bashkëngjitur aktin e vendosjes së kushteve ndërtimore.



Gjithashtu, Leja Mjedisore Komunale (LMK) është kusht për marrjen e lejes ndërtimore, kërkesë e nenit 20.3.5 e Ligjit për ndërtim. Me rastin e kërkesës për leje ndërtimore bashkëngjitet edhe vlerësimi i ndikimit në mjedis për ato ndërtime siç kërkohet me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit nr. 03/L-025. Komuna në këto tri raste nuk e ka zbatuar këtë obligim ligjor. Gjithashtu, edhe sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 01/2017, neni 6.2 për dhënien e Lejes mjedisore komunale (LMK), parasheh si kusht LMK për marrjen e lejes ndërtimore. Komuna nuk ka qenë në dijeni se ligji parasheh apo kërkon lejen mjedisore, dhe sipas deklaratave zyrtare LMK nuk është lëshuar apo aplikuar as njëherë.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mungesës së resurseve si dhe neglizhenca apo pakujdesia e zyrtarëve përgjegjës, të cilët nuk kanë qenë në dijeni të procedurave të parapara me ligj, dhe se kjo procedurë duhet respektuar gjatë procesit të lëshimit të lejeve ndërtimore.

#### **Rreziku**

Mangësitë e identifikuar kanë rezultuar me mosrespektim të ligjit dhe rregullave në fuqi. Gjithashtu, me këto raste komuna nuk ka shfrytëzuar edhe mundësinë ligjore për realizimin e të hyrave për shkak se aplikimi i lejeve mjedisore do të rezultonte me pranimin e tarifës dhe sigurimin e të hyrave nga ky aktivitet.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë që është ndërmarrë një shqyrtim i kontrolleve nëlidhje me menaxhimin e procesit për leje ndërtimi dhe që kontrollet janë ri dizajnuar për ta adresuar problemin. Proceset e rishikuara duhet të sigurojnë që të respektohet kronologjia e proceseve me rastin e aplikimit dhe sigurohet se dhënia e lejes ndërtimore bëhet vetëm atëherë kur të gjitha kërkesat ligjore janë plotësuar, si kushtet ndërtimore dhe leja mjedisore.

#### **Çështja A4 - Parregullsi në kalkulimin e të hyrave nga tatimi në pronë**

##### **Gjetja**

Bazuar në Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr.03/L-204 neni 9 precizon se “çdo person fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos që prona ose njësia e banimit që shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej dhjetëmijë euro (10.000€) nga vlera e tatueshme e pronës”. Në pesë raste tatimpaguesit kishin përfituar zbritjen për banim primar në më shumë se një pronë kjo ka ndikuar që të hyrat në këto raste të nënvlerësohen për 75€ në vit.

Po ashtu sipas nenit 1 të rregullores komunale duke u bazuar në vend ndodhjen e pasurisë, janë përcaktuar tri zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerësimin e pasurisë që tatóhet. Në tre raste prona tatimore nuk ishte vlerësuar sipas zonave tatimore të përcaktuara në rregullore, në rastin e parë tatimi për këtë pronë ishte përlogaritur duke marrë për bazë zonën e III ndërsa sipas

---

rregullores i takonte zonës II, kurse në dy raste tjera pronat ishin vlerësuar duke marrë për bazë zonën III, ndërsa i përkisnin zonës I gabimi financiar në këtë rast arrin vlerën 70€ për vit.

Në një rast prona e cila i takonte kategorisë komerciale ishte kategorizuar si industriale. Kjo ka ndikuar në nënvlerësim të obligimit tatimor prej 23€/vit.

Këto gabime kanë rezultuar si shkak i mungesës së rishikimit nga ana e zyrtarëve që me rastin e futjes së të dhënave në sistem të bëjnë verifikimin dhe konfirmimin e tyre. Edhe pse efekti financiar i mospërputhjeve të identifikuar nuk konsiderohet se është i lartë, vet fakti i ekzistimit të mangësive të tilla është tregues i mungesës së efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

**Rreziku** Situata të kësaj natyre rezultojnë me ngarkesa të pasakta të tatimit në pronë dhe në këtë mënyrë dëmton buxhetin e komunës në rastet e nënvlerësimit të obligimit tatimor.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurohet se kontrollet janë funksionale dhe menaxheri i tatimit monitoron procesin e regjistrimit, evidentimin e të dhënave reale të pronës. Gjithashtu, të sigurohet se gjatë procesit të verifikimit, identifikohen dhe eliminohen dobësitë ekzistuese në sistem, bazuar me gjendjen faktike në teren, në mënyrë që ngarkesat e tatimit të jenë reale.

#### **Çështja A5 - Informata jo të plota në dosjet e tatimpaguesve**

**Gjetja** Sipas nenit 14 të UA nr.03/2011 me rastin e regjistrimit të të dhënave në sistem nga operatorët merren këto informata: numri i ndërtesës, numri i njësisë dhe numri i tatimpaguesit. Gjithashtu, neni 5.8 i të njëjtit udhëzim parasheh që dosjet e tatimpaguesve të përmbajnë edhe fotografitë e objekteve dhe neni 12 i këtij udhëzimi kërkon që zyrtari përgjegjës komunal për tatimin në pronë duhet të rishikojë të gjitha të dhënat si dhe të bëjë verifikimin dhe konfirmimin e tyre.

Nga tetë rastet e audituara, në pesë prej tyre tatimpaguesit kishin marrë më shumë se një numër identifikues. Në një rast mungonin fotografitë e pronës si dhe numri personal i tatimpaguesit.

Kjo ka ndodhur si shkak i neglizhencës të anketuesve në teren dhe mungesës së rishikimit të zyrtarëve që fusin të dhënat në sistem.

**Rreziku** Informata jo të plota në dosjet e tatimpaguesve nuk ofrojnë një gjendje reale të pronave të tatueshme dhe vështirëson kalkulimin e drejtë të tatimit.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e tatimit në pronë një plan të detajuar afatmesëm për të eliminuar dobësitë e identifikuarra, dhe zbatimi i këtij plani të mbikëqyret në baza të rregullta duke mundësuar eliminimin e dobësive të identifikuarra.

#### Çështja A6 - Vonesa në Arkëtimin e Qirasë

**Gjetja** Sipas kontratave të nënshkruara nga ana e komunës si qiradhënës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës qiraja mujore/vjetore duhet të paguhet brenda afatit të përcaktuar në kontratë<sup>8</sup>.

Në katër raste të audituara kishte vonesa në shlyerjen e obligimeve të qiramarrësve ndaj komunës, ku në dy prej tyre komuna nuk kishte ndërmarrë asnjë hap për arkëtimin e këtyre të hyrave. Shuma e borxhit ishte 11,965€.

Mos faturimi i rregullt nga ana e komunës, mos aplikimi i masave efektive për arkëtimin e të hyrave ka ndikuar në vonesa në arkëtimin e të hyrave nga qiraja dhe ka pasuar me papërgjegjësinë e qiramarrësve për të paguar.

**Rreziku** Menaxhimi i dobët i kontratave për pronat e dhëna në shfrytëzim rrit rrezikun që komuna të ketë një performancë të dobët në mbledhjen e të hyrave dhe mos realizim të projekteve që priten të financohen nga këto të hyra, si dhe rritjen e vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme të komunës.

**Rekomandimi A6** Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave në përputhje me kushtet e kontraktuarra. Drejtoritë përkatëse që menaxhojnë këto të hyra duhet të aplikojnë faturim dhe arkëtim të rregullt, në të kundërtën të ndërmerren masa për shkëputjen të kontratës.

<sup>8</sup> Për kontratën nr 02-531 pagesa mujore duhet të bëhet deri me datë 3 të secilit muajit rrjedhës, për kontratat 02-725 dhe 09-221 pagesat e qirasë deri me 1 prill për vitin paraprak si dhe kontrata 01-469 parasheh kryerjen e pagesës deri më 30.11 të vitit rrjedhës.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 1,857,279€ prej të cilit gjatë vitit janë shpenzuar 100% të asaj që është buxhetuar. Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF.

#### Rekomandimet

#### Çështja A7 - Mos ofrimi i dëshmime / mungesë e argumente për vijueshmërinë në punë

**Gjetja** Sipas Udhëzimit Administrativ për Zbatimin e të drejtave dhe përgjegjësive të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Entiteteve të Audituar, neni 11.2 kërkon që zyrtarët e OB që i nënshtrohen auditimit janë të detyruar t'iu përgjigjen kërkesave të personelit të autorizuar nga ZKA lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me auditimin. Gjithashtu, sipas nenit 13.5 me kërkesë të personelit të autorizuar, zyrtari përgjegjës i entitetit, brenda një kohe të arsyeshme duhet të ofroj çfarëdo informacioni të kërkuar, prezantoj dhe të jap dëshmi të besueshme dhe relevante dhe të ofroj dokumentet e kërkuara në lidhje me detyrat nën menaxhimin apo kontrollin e atij zyrtari.

Nga 20 rastet e audituar në drejtorinë e arsimit, për 14 prej tyre nuk na është ofruar dëshmi për vijueshmërinë në punë, me c' rast e kishim të pamundur të konfirmonim që mësimdhënësit kanë punuar edhe pse ata paguhen me paga të rregullta. Pagesa bruto për këta punëtorë gjatë vitit 2018 ishte 43,393€.

Mos ofrimi i këtyre dëshmime ishte për shkak se këta punëtor janë të angazhuar në shkollat që menaxhohen nga strukturat paralele, ndonëse mësimdhënësit në fjalë paguhen nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Komuna kishte të zgjedhur me konkurs apo rekrutuar edhe drejtor të cilat paguhen nga buxheti komunal për menaxhimin e po të njëjtave institucione.

**Rreziku** Mos ofrimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara për auditim është në kundërshtim me legjislacionin dhe kufizon mundësinë e auditimit të rregullt për shpenzimet e pagave në këto raste. Pagat për punëtor që edhe mund të jenë fiktiv apo nuk punojnë fare, paraqesin bazë për mashtrim dhe mund të rezultojnë me humbje financiare për komunën.

**Rekomandimi A7** Kryetari të siguroj se të gjithë të punësuarit në shkollat të cilat funksionojnë brenda fushëveprimit të komunës janë menaxhuar dhe kanë ofruar kontributin-shërbimin për të cilin janë kompensuar. Mungesa e argumenteve për vijueshmërinë e punës kërkon zbatimin e masave ndaj përgjegjësve dhe ofrimin e llogaridhënies për situatën jashtë kontrollit.

## Çështja A8 - Dobësi në procesin e rekrutimit

**Gjetja** UA 07/2017 për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Neni 9.5 parasheh që aplikuesit duhet ti nënshtrohen testimit me rastin e punësimit. Me rastin e punësimit të dy punonjësve në arsim/ mësues për edukatë qytetare dhe gjeografi, komuna nuk ka zhvilluar testim me shkrim, por vetëm intervistimin e kandidatëve potencial.

Me rastin e rekrutimit të zyrtarit për “Planifikim dhe Zhvillim” dhe “Zyrtar për Emergjencë” komuna nuk i ka respektuar kriteret e përcaktuara me konkurs<sup>9</sup> në procesit e përzgjedhjes së kandidatëve. Sipas konkursit për zyrtar për planifikim dhe zhvillim kandidati duhej të kishte të përfunduar fakultetin e ndërtimtarisë apo arkitekturës ndërsa kandidati i pranuar ka të përfunduar shkollën e lartë të ndërtimtarisë.

Kurse kandidati për “Zyrtar të Emergjencave” sipas konkursit duhet të kishte të përfunduar fakultetin për menaxhim të emergjencave dhe një vit përvojë pune, kandidati i përzgjedhur kishte të përfunduar fakultetin e gjeografisë dhe nuk kishte përvojë pune.

Kjo për shkak të mungesë së kompetencës të zyrtareve përgjegjës apo njohurive të mangëta mbi ligjin dhe procedurat që duhet aplikohen me rastin e rekrutimit. Gjithashtu, edhe komisionit i ngarkuar për përzgjedhje nuk ishte kompetent për kryerjen e obligimit apo vlerësimin e drejt bazuar në kriteret.

**Rreziku** Komuna rrezikon menaxhim jo adekuat të burimeve njerëzore e cila rezulton me pranim të punonjësve jo kompetent për pozitat adekuate. Mos respektimi i kërkesave që dalin nga rregullat përkatëse lidhur me shpalljen dhe themelimit e marrëdhënies së punës mundësojnë ndërhyrje të parregullta në proceset rekrutuese dhe kontrole jo adekuate me rastin e pranimit të punonjësve të ri.

**Rekomandimi A8** Kryetari duhet t'i rishikojë shkaqet që kanë reflektuar menaxhim jo të mirë të burimeve njerëzore, dhe të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behën përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore, duke mbajtur përgjegjës personat e vendosur për aplikim të proceduarve ligjore të rekrutimit dhe vlerësim korrekt të aplikuesve.

<sup>9</sup> Rregullorja për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil 02-2010, neni 19, Shqyrtimi i aplikacioneve është faza e parë e përzgjedhjes në procesin e rekrutimit. Qëllimi i shqyrtimit është përgatitja e një listë të shkurtër të kandidatëve të kualifikuar për procedim të mëtejshëm pas vlerësimit të profilin, meritave dhe përputhshmërisë së tyre me kërkesat e përcaktuara për pozitën përkatëse.

---

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 297,857€. Prej tyre ishin shpenzuar 263,208€. Ato kanë të bëjnë me shërbime kontraktuese tjera, shpenzime komunale, derivate dhe shpenzime tjera.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja B2 – Angazhim i parregullt i stafit për shërbime të veçanta

**Gjetja** Angazhimi i punonjësve duhet të bëhet vetëm në ato raste, kur për ndonjë punë të caktuar specifike, kërkohet ekspert i fushës përkatëse. Ligji i shërbimit civil Neni 12.4 Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Rishikimi ynë i angazhimeve të punëtorëve me kontratë për shërbime të veçanta ka identifikuar se komuna kishte të angazhuar 6 punëtor me kontratë për shërbime të veçanta si: Zyrtar për regjistrimin e automjeteve, mirëmbajtësirrjetit të ujësjellësit në territorin e komunës, arkëtar të faturave të ujësjellësit si dhe zyrtar për konsumator dhe arkëtim në ujë sjellëses. Përzgjedhja e këtyre punëtorëve ishte bërë pa asnjë procedure, dhe në pesë raste ishte tejkalar afti ligjor i angazhimit, mbi 6 muaj.

**Rreziku** Anashkalimi i procedurave të rekrutimit me rastin e lidhjes së kontratave për shërbime të veçanta, rrit rrezikun të rezultojë me angazhimin e personave jo të duhur për kryerjen e shërbimeve të kërkuara, si dhe nuk siguron konkurrencë potenciale.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojnë se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta të bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, por kërkohet ekspert i një fushe specifike. Si dhe angazhimi me marrëveshje apo kontratë për punë specifike bëhet në përputhje me kërkesat ligjore për të siguruar se angazhimet bëhen përmes një procesi konkurrues dhe transparent.

---

**Çështja A9 - Vonës në pagesë të faturave**

**E gjetura** Komuna në pesë raste nuk i ka paguar faturat në afatin e paraparë ligjor siç kërkohet me nenin 39.1 të LMFP nr. 03-L048. Ky nen këkon që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike. Arsyet e ndodhjes ishte shkaku i mungesës së mjeteve të buxhetuara. Vonesat ishin nga një deri në 16 muaj.

**Rreziku** Mos pagesa e obligimeve financiar brenda afatit ligjor rrit rrezikun që komuna të jetë objekti i padive gjyqësore dhe të ketë humbje financiare për mbulimin e shpenzimeve të procedurave gjyqësore dhe shpenzimeve të interesit.

**Rekomandimi A9** Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna ka mjete të mjaftueshme të buxhetuara paraprakisht.

**3.1.4 Subvencionet dhe transferet**

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 10,064€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 10,058€. Ato kanë të bëjnë me subvencionime të ndryshme nga fusha e bujqësisë, kulturës, arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies etj.

**Rekomandimet**

---

**Çështja A10 -Mungesë dokumentimi me rastin e ndarjes së subvencioneve**

**E gjetura** Sipas rregullores komunale për subvencione, neni 10 përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmës materiale si: sëmundja erënd e konstatuar me dokumentacion mjekësor specialist; dëshmi për gjendjen erënd ekonomike si dhe dëshmi të shpenzimeve mjekësore. Në dy raste të audituara në vlerë prej 900€<sup>10</sup>, (një banorë i komunës së Gjilanit dhe një i komunës së Novobërdës), mungonte dokumentimi për përcaktimin e sëmundjes, gjendjen ekonomike si dhe dëshmitë e shpenzime për të konfirmuar qëllimin e subvencionit.

---

<sup>10</sup> Subvencionet e dhëna për dy persona fizik nga 450€.



**Rreziku** Mos zbatimi i dispozitave të rregullores së brendshme për dhënien e subvencioneve rritë rrezikun e ndarjes së subvencioneve në mënyrë subjektive dhe që ndihma momentale t’u ndahet personave jo meritator, si dhe redukton mundësinë e dhënies së subvencioneve personave tjerë në nevojë.

**Rekomandimi A10** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se me rastin e dhënies së subvencioneve, të zbatoj të gjitha dispozitat e rregullores. Për marrjen e vendimit të rregullt dhe korrekt, kërkesës për subvencionim dhe pagesës duhet ti bashkëngjiten dëshmi, që arsyetojnë ndarjen mjeteve dhe arritjen e qëllimit të subvencionit.

### Çështja A11 - Mosrespektim i procedurave në ndarje të subvencioneve

**E gjetura** Pagesa prej 2,000€ sipas marrëveshjes së mirëkuptimit në mes komunës së Novobërdës, Graçanicës dhe OJQ “CPT” dhe aneks marrëveshjes ndërmjet komunës së Novobërdës dhe OJQ “CPT”, është subvencionim i OJQ për realizimin e projektit për “Ndihma për të diplomuarve nga komuniteti pakicë për t’u kyçur në administratën publike në nivel qendror dhe lokal”. Mirëpo marrëveshja e mirëkuptimit ishte bërë duke anashkaluar procedurat e përcaktuar me Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, ku kerkohet konkurrueshmëri, transparencë, trajtim i barabartë dhe mos diskriminim. Gjithashtu, pagesa është në kundërshtim me nenin 6.2 të Rregullores komunale për ndarje të subvencioneve, pasi që kryetari ka të drejt vetëm deri në 1,000€ të ndaj subvencione. Kjo ka ndodhur për shkak se kryetari i komunës nuk ka përfillur procedurat e parapara për hyrjen në marrëveshje të mirëkuptimit që ka për qëllim subvencionimin e këtij projekti, nga e cila rrjedhin edhe obligime financiare për komunën.

**Rreziku** Obligime financiare, bazuar në marrëveshje pa u përfillur procedurat e përcaktuara ligjore, mundësojnë mos arritjen e qëllimi për të cilën bëhet pagesa apo paraja publike të keqpërdoret.

**Rekomandimi A11** Kryetari të sigurohet se marrëveshjet duhet të nënshkruhen vetëm atëherëku paraprakisht janë zbatuar të gjitha procedurat e përcaktuar ligjore, me qëllim që paratë publike të kontrollohen dhe financimi i OJQ të jetë në përputhje me rregullat.



### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 560,425€, ndërsa shpenzimet janë 415,481€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e realizuara për shtrimin e rrugëve lokale, kanalizime, ujësjellës etj.

Në planin e prokurimit ishin planifikuar 12 aktivitete, prej të cilave ishin realizuar 10. Sipas zyrës së prokurimit mos realizimi i dy procedurave “Mirëmbajtja e Ndriçimin Publik” si dhe “Ndërtimin i Çerdhes” arsyetje e mos realizimit ka qenë mungesa e fondeve apo kodeve buxhetore.

Jashtë planifikimit të prokurimit janë realizuar 6 aktivitete të prokurimit, nga të cilat katër (4)<sup>11</sup> projekte të përfituara nga donatorët e ndryshëm gjatë vitit fiskal, dhe dy (2)<sup>12</sup> kontrata tjera për shërbime apo furnizim, bazuar në kërkesat e miratuara nga kuvendi i komunës.

#### Rekomandimet

##### Çështja A12 - Projektet pa plan ekzekutiv të ndërtimit

**Gjetja** Sipas kërkesës e nenit 28.10 e LPP, specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Autoriteti Kontraktues (AK) është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë AK nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në dy nga katër rastet e audituar, komuna nuk kishte bashkëngjitur projektin ekzekutiv në dosjen e tenderit. Pra komuna në dy <sup>13</sup> raste kishte kontraktuar punë pa hartuar projektet ekzekutive, ku përcaktohet përshkrimi i hollësishëm i projektit dhe ekzekutimi ishte bërë duke u bazuar vetëm në projektin ideor. Kjo kishte rezultuar për shkak të mungesës së kuadrit profesional brenda komunës.

**Rreziku** Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv rezulton me mos respektim të kërkesë ligjore dhe mundëson realizim të dobët të

<sup>11</sup> “Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në Draganc Komuna e Novobërdës”; “Furnizim me lodra për rregullimin e parkut për fëmijë në fshatin Kufc dhe Bushinc”; “Rregullimi (Ndërtimi) i stadiumit për futboll të vogël në fshatin Prekoç”; “Asfaltim i rrugëve lokale në fshatin Qulkovc”.

<sup>12</sup> “Furnizim me Lopë Qumështore për subvencionim të fermerëve” “Vizitë pune në Durrës për Përgatitjen e Kornizës Afatmesme buxhetore 2019-2021”

<sup>13</sup> Asfaltimi i rrugëve lokale nr. i kontratës 654-2018-020-521 ” Lot 1 në vlerë 44,615.56€, dhe Lot 2 në vlerë 41,936.91€.

kontratave për punë të pa projektuara, duke ndikuar në shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

**Rekomandimi A12** Kryetari duhet të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore duke rishikuar implementimin e ligjit të prokurimit. Me rastin e kontraktimit të punëve duhet të sigurohet paraprakisht se projektet janë hartuar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. Sigurimi i projektit ekzekutiv duhet të shërbej si bazë për fillimin e procesit, zhvillimi e prokurimit, dhe kontraktimit të punëve, në të kundërtën fillimi i procesit të prokurimit nuk është i lejuar sipas ligjit.

### Çështja A13 - Shpenzime shtese sipas vendimeve gjyqësore

#### Gjetja

Bazuar në urdhrin përmbartimor me datë 05.09.2018 thesari ka ekzekutuar pagesën në emrin e komunës në vlerë 2,972€ (si gjobe 2,500€ dhe shpenzime përmbartimore 472€), për shkak të mos respektimit të aktvendimit të inspektoratit, për lidhjen e kontratës me kohë të pacaktuar me punëtorët e arsimit. Nga ky rast ishte gjobit ndaras edhe Drejtori Drejtorisë së arsimit. Komuna kishte parashtruar ankesë në agjencinë ekzekutiv të inspektoratit i cili e ka hedhur si të pa bazë duke vërtetuar vendimin e shkallës së parë inspektoratit.

Për të njëjtin rast Gjykata Themelore e Gjilanit, dega Novobërdë kishte nxjerr aktvendim me 6.12.2018 duke shqiptuar dënim personit juridik/komunës prej 4,000€ për dy punëtor të larguar të arsimit, për mos respektim të aktvendimit të organit ekzekutiv inspektoratit dhe aktvendimit të gjykatës për tu përgjigjur ftesës për pagës si dhe mos ofrimit të arsytimit për mos pranin e komunës në seancë gjyqësore. Gjykata po ashtu në këto raste ndaras kishte shqiptuar gjobë edhe për pësonin përgjegjës- drejtorin e arsimit. Pra komuna respektivisht Drejtorja e Arsimit<sup>14</sup> nuk ju kishte përgjigjur vendimeve të obligueshme të organeve përgjegjës, duke paguar vendim përmbartimor apo duke u gjobitur si Drejtori e Arsimit<sup>15</sup> / komunë dhe gjobë individuale për udhëheqësin /Drejtorin.

<sup>14</sup> Pagesa e gjobës – 2,972.40€ për përmbartuesin privat (pagesa e gjobës - inspektoratit/përfituesi MMPS -2,500€; shpenzimet e procedurës përmbartimore 471.90€; shuma për transfer të mjeteve 0.50€). Pagesa bazuar në aktvendimin e gjykatës (përfitues KGJK) për moskthimin e punëtorit M.C. pagesa e dënimit 2,000€ dhe pagesa sipas aktvendimit gjyqësor – për moskthim të punëtorit G. S. -pagesa e dënimit 2,000€ (përfitues KGJK).

Pagesat ishin pasoj e mosrespektimit të vendimeve të obligueshme të organeve relevante për kthimin e punëtoreve dhe buxheti komunal/ nga investimet kapitale ishte dëmtuar në shumën prej 6,972€.

**Rreziku** Kjo ka rezultuar me shpenzim shtesë dhe gjobitje direkte të komunës apo edhe zyrtareve kompetent/ udhëheqësve duke dëmtuar buxhetin komunal dhe vet imazhin e komunës.

**Rekomandimi A13** Kryetari duhet të sigurohet që ndërprerja e marrëdhënies së punës me punëtorit bëhet vetëm në ato raste ku ka dëshmi, fakte apo ka bazë ligjore për shkëputje të kontratës. Gjithashtu, kur paraqitet nevoja e ballafaqimit me organet relevante duhet të ndërmarrën hapa konkret nga ana e komunës për përfaqësimin e drejt dhe prezantimin me kohet të dëshmive, fakteve që mbështesin vendimin e menaxhmentit në këto raste. Në të kundërtën vendimet e organeve përkatëse duhet të respektohen duke mos lejuar shpenzimet shtesë apo pagesën e gjobave të shqiptuar që dëmtojnë parat e taksapaguesve.

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna e Novobërdës kishte shpалosur në PFV pasuri kapitale në vlerë prej 1,210,147€, ndërsa pasuria jo kapitale, në vite me radhe nuk është evidentuar dhe shpалosur në PVF.

### Rekomandimet

#### Çështja B3 – Dobësi në menaxhimin e pasurisë

**Gjetja** Komuna kishte themeluar Komisionin për inventarizimin e pasurive, mirëpo komisioni nuk kishte arritur ta përmbyll procesin siç parasheh rregullorja 02/2013, neni 19.4.7 dhe të nxjerrë një raport mbi ekzistencën dhe gjendjen e pasurive deri me 31.12.2018. Si rrjedhojë, rezultatet e inventarizimit nuk ishin reflektuar në PFV.

Komuna edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka arrit të regjistroj automjetet, tokave dhe ndërtesave që janë në pronësi të komunës edhe pse është rekomanduar edhe vitin e kaluar.

Gjithashtu, komuna nuk e aplikon sistemin e-pasuria për regjistrim e pasurisë, duke bërë që pasuria jo kapitale e shpалosur në PFV të jetë zero në tri vitet e fundit.

**Rreziku** Dobësitë e identifikuar vështirësojnë menaxhimin adekuat të pasurisë dhe nuk prezantojnë gjendjen dhe vlerën reale të pasurisë me të cilat disponon organizata. Fakti i mos aplikimi të E-pasurisë në kushte të tilla, bënë që pasuria jo kapitale ti ekspozohet rrezikut për humbje, keqpërdorim apo tjetërsim.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë të bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 02/2013. Një komision i veçantë duhet të krijohet për të identifikuar mangësitë e sistemit dhe për të siguruar se tërë pasuria është identifikuar dhe evidentuar në regjistrin e pasurisë.

### 3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës si tatim, taks, qira, shërbim i pa paguar ende. Komuna ka prezantuar në PFV llogarinë e pa arkëtuar që përfshinte vetëm të hyrat e pa realizuar nga tatimi në pronë në vlerë prej 360,158€.

#### Rekomandimet

#### Çështja B4 - Rritja e Vazhdueshme e Llogarive të Arketueshme

**Gjetja** Llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë krahasuar me vitin paraprak ishin rritur për 17% apo 52,199€ më shumë. Trendi rritës i këtyre llogarive paraqet shqetësim për komunën në vitet e ardhshme.

Kjo situatë ka ardhur për arsye se komuna nuk kishte aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e këtyre llogarive të arkëtueshme nga vitet paraprake, dhe nuk ka zbatuar të gjitha masat ligjore të cilat parashihen në ligj dhe udhëzimet administrative.

**Rreziku** Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mbeten sfidë edhe për periudhën e ardhshme. Mos arkëtimi i të arkëtueshmeve rrezikon vjetërsimin e tyre dhe rritjen e vështirësisë për mbledhjen e tyre duke krijuar humbje të drejtpërdrejtë financiare për komunën.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të vendosë politika dhe mekanizma të tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke vendos si prioritet obligimet me vlerë më të lartë dhe duke i kushtuar kujdes vjetërsisë së llogarive të arkëtueshëm. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj tatimpaguesve të cilët nuk i përmbushin obligimet tatimore.

### 3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 78,229€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore me të cilat përballet Komuna. Ne kemi identifikuar edhe dobësi tjera në këtë kategori përveç çështjes së theksuar te opinioni i auditimit për mos shpalosje të obligimeve në PVF.

#### Rekomandimet

##### Çështja B5 - Mos raportimi i obligimeve në thesar

- E gjetura** Komuna nuk e kishte bërë raportimin e rregullt mujor të obligimeve, kërkesë e Rregullës Financiare 02/2013 të MF-së. Sipas nenit 5.2 të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara. Raportimi, sipas kësaj rregulle financiare, bëhet përmes raporteve mujore duke përfshirë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur. Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionim të kontrolleve me rastin e pranimit dhe shpërndarjes së dokumenteve, apo destinimin në drejtorin dhe te zyrtaret përkatës.
- Rreziku** Mos raportimi i rregullt mujor i obligimeve jo vetëm që është në kundërshtim me rregullat financiare, por mund të rezultojë edhe me menaxhim të dobët të obligimeve, përballje me drejtësinë për vonesat në ekzekutimin e tyre dhe me pagesa të paplanifikuara nga buxhetet e viteve vijuese.
- Rekomandimi B5** Kryetari, duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara, të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF në përputhje me kërkesat ligjore.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës së Novobërdës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. OB nuk kishte përmbushë as kërkesën e MF lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjikenë nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Në vlerësojmë se komuna nuk posedon planet strategjik, pasi dokumentet e kërkuar nuk na janë ofruar nga komuna.

Qeverisja e Komunës në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë negative. Komuna nuk ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Qarkullimi i dokumentacionit brenda komunës, komunikimi, ruajtja e të dhënave apo informatave len vend për tu dëshiruar.

Gjithashtu përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, ende nuk janë të vendosura si duhet sepse komuna nuk ka zbatuar një pjesë të rekomandimeve deri në përfundim të vitit 2018. Auditimi i Brendshëm nuk kishte arritur të ofroj një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme edhe pse kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre. Komiteti i auditimit nuk ishte themeluar gjatë vitit 2018 (tek në fillim të vitit 2019 komuna ka themeluar KA).

## 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon vetëm me një anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

### **Rekomandime**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

---

## Rekomandimi

---

### Çështja B6 – Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**Gjetja** Vlerësimi i dobët i nevojave, mbikëqyrja e pamjaftueshme dhe obligimet e mbetura, nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit.

Organizata gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk ekziston regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitet raport për menaxhimin e tyre.

**Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i larte. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komunës së Novobërdës ka rezultuar në 10 rekomandime kryesore. OB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'izbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, gjashtë (6) rekomandime përsëriten, një (1) rekomandim i mbyllur i pa zbatuar, si dhe vetëm tri (3) rekomandime janë zbatuar.



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarrë	Statusi
1	PVF dhe Raportimi	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit, si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë kapitale. E gjitha pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare të blera/ndërtuara duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Nuk është marrë ndonjë veprim, PVF të vitit 2018 janë prapë me gabime.	Rekomandim i pa zbatuar/ i përsëritur.
2	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas zhvillimit të procedurave të thjeshtësuara të rekrutimit, si dhe të shtoj kontrollin me rastin e pagesave të tilla duke respektuar procedurat për ndaljen e tatimit në burim si dhe kontributeve pensionale.	Nuk është marrë ndonjë veprim.	Rekomandim i pa zbatuar/ i përsëritur.
3	Investime Kapitale	Kryetari i Komunës duhet të forcoj mbikëqyrjen efektive menaxheriale për të siguruar se janë ndërprerë plotësisht praktikat e lidhjes së kontratave pa procedura si dhe të siguroj se gjatë vitit 2018 të gjitha shpenzimet për investime kapitale realizohen në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të prokurimit. Me tutje, të sigurojë se janë duke u respektuar të gjitha kërkesat e dala nga marrëveshjet e arritura për bashkëfinancim.	Nuk kemi rastë kur është nënshkruar kontrata pa procedura .	Rekomandim i zbatuar.

4	Investime Kaptale	Kryetari i Komunës duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e shfrytëzimit të automjeteve në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregullore. Për shfrytëzimin e automjeteve paraprakisht duhet të bëhet aprovimi, e më pas duhet të mbahen evidenca të plota për shfrytëzimin e tyre, përfshirë edhe mirëmbajtjen e tyre.		Rekomandim i zbatuar.
5	Menaxhimi i Pasurisë	Kryetari duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme, për të siguruar funksionalizimin e sistemit e-pasuria dhe evidentimin e të gjitha pasurive më vlerë nën 1,000€ dhe stoqeve në këtë sistem. Me pas në fund të vitit para përgatitjes së pasqyrave financiare të kryhet procesi i inventarizimit i cili mundëson krahasimin e me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, dhe diferencat e mundshme të pasqyrohen në regjistrat e pasurive.	Nuk është marre ndonjë veprim.	Rekomandim i pa zbatuar/ i përsëritur.
6	Llogaritë e Arketueshme	Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arketueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, për të siguruar arkëtimin me kohë të llogarive të arketueshme.	Nuk është marre ndonjë veprim.	Rekomandim i pa zbatuar/ i përsëritur.
7	Obligimet e pa paguara	Kryetari, duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.	Nuk është marre ndonjë veprim.	Rekomandim i pa zbatuar / i përsëritur.
8	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Nuk është marre ndonjë veprim.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.

9	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të forcoj rolin e NJAB-së si element kyç i sistemit të kontrollit të brendshëm për të nxjerrë auditime cilësore, të sigurojë se përgatiten planet e veprimit për secilin raport të auditimit si dhe në mënyrë sistematike të monitorojë progresin kundrejt planit për të siguruar zbatimin e rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara. Me tutje duhet të sigurojë themelimin e komitetit të auditimit si dhe funksionimin e rregullt të tij, për të siguruar pavarësinë e NJAB-së.	Në fillim të vitit 2019 është themeluar KAB.	Rekomandim i zbatuar.
10	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të siguroj se ka hartuar të gjitha planet operative si dhe është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, komuna duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Nuk është marre ndonjë veprim.	Rekomandim i pa zbatuar/ i përsëritur.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Pasqyra Financiare dhe Raportimi	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikimin e opinionit dhe theksimit të çështjes, në këtë raport. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet për të siguruar se të gjitha shpenzimet klasifikohen drejtë sipas kategorive ekonomike si dhe pasqyrat prezantohen në përputhje me kërkesat e rregullores së MF-së për raportimin vjetor financiar. Po ashtu, kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë komunale (janë të evidentuara në regjistrat e pasurisë) dhe llogarit e arkëtueshme, obligimet janë shpalosur drejtë në PFV-të e vitit 2018. Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtaari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2018 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitet e ardhshme. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.		
3	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari të siguroj se janë ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për të planifikuar buxhet të mjaftueshëm krahas detyrimeve/obligimeve që pret komuna të përballet, për të ju dhënë prioritet shlyerjes së këtyre obligimeve me kohë, si dhe të prezantojë drejtë shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe natyrës reale të shpenzimeve.		

4	Të Hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që është ndërmarrë një shqyrtim i kontrolleve në lidhje me menaxhimin e procesit për leje ndërtimi dhe që kontrollet janë ri dizajnuar për ta adresuar problemin. Proceset e rishikuara duhet të sigurojnë që të respektohet kronologjia e proceseve me rastin e aplikimit dhe sigurohet se dhënia e lejes ndërtimore bëhet vetëm atëherë kur të gjitha kërkesat ligjore janë plotësuar, si kushtet ndërtimore dhe leja mjedisore.
5	Të Hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se kontrollet janë funksionale dhe menaxheri i tatimit monitoron procesin e regjistrimit, evidentimin e të dhënave reale të pronës. Gjithashtu, të sigurohet se gjatë procesit të verifikimit, identifikohen dhe eliminohen dobësitë ekzistuese në sistemit, në raport me gjendjen faktike në teren, në mënyrë që ngarkesat e tatimit të jenë reale.
6	Të Hyrat	Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e tatimit në pronë një plan të detajuar afatmesëm për të eliminuar dobësitë e identifikuar, dhe ta mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e atij plani duke mundësuar eliminimin e dobësive të identifikuar.
7	Të Hyrat	Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave në përputhje me kushtet e kontraktuara. Drejtorit përkatëse që menaxhojnë këto të hyra duhet të aplikojnë faturim dhe arkëtim të rregullt në të kundërtën të ndërmerren masa për shkëputjen të kontratës.
8	Paga dhe Mëditje	Kryetari të siguroj gjithë të punësuarit në shkollat të cilat funksionojnë brenda fushëveprimit të komunës janë menaxhuar dhe kanë ofruar kontributin-shërbimin për të cilin janë kompensuar. Mungesa e argumenteve për vijueshmërinë e punës kërkon zbatimin e masave ndaj përgjegjësve dhe ofrimin e llogaridhënies për situatën jashtë kontrollit.
9	Paga dhe Mëditje	Kryetari duhet t'i rishikojë shkaqet që kanë reflektuar menaxhim jo të mirë të burimeve njerëzore, dhe të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behën përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore, duke mbajtur përgjegjës personat e vendosur për aplikim të proceduarve ligjore të rekrutimit dhe vlerësim korrekt të aplikuesve.
10	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojnë se angazhimi i zyrtarëve me Marrëveshje për shërbime të veçanta të bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, por kërkohet ekspert i një fushe specifike. Si dhe angazhimi me marrëveshje apo kontratë për punë specifike bëhet në përputhje me kërkesat ligjore për të siguruar se angazhimet bëhen përmes një procesi konkurrues dhe transparent.
11	Mallra dhe Shërbime	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositorja e mallrave punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna ka mjete të mjaftueshme të buxhetuara paraprakisht.
12	Subvencione	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se me rastin e dhënies së subvencioneve, me konsistencë do të zbatoj të gjitha dispozitat e rregullores. Për marrjen e vendimit të rregullt dhe korrekt, kërkesës për subvencionim dhe pagesës duhet ti bashkëngjiten dëshmi, që arsyetojnë ndarjen mjeteve dhe arritjen e qëllimit të subvencionit.

13	Subvencione	Kryetari të sigurohet se marrëveshjet duhet të nënshkruhen vetëm atëherë ku paraprakisht janë zbatuar të gjitha procedurat e përcaktuar ligjore, me qëllim që parandë publike të kontrollohen dhe financimi i OJQ të jetë në përputhje me rregullat.
14	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore duke rishikuar implementimin e ligjit të prokurimit. Me rastin e kontraktimit të punëve duhet të sigurohet paraprakisht se projektet janë hartuar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. Sigurimi i projektit ekzekutiv duhet të shërbej si bazë për fillimin e procesit, zhvillimi e prokurimit, dhe kontraktimit të punëve, në të kundërtën fillimi i procesit të prokurimit nuk është i lejuar sipas ligjit.
15	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që ndërprerja e marrëdhënies së punës me punëtorit bëhet vetëm në ato raste ku ka dëshmi, fakte apo ka bazë ligjore për shkëputje të kontratës. Gjithashtu, atëherë kur paraqitet nevoja e ballafaqimit me organet relevante duhet të ndërmarrën hapa konkret nga ana e komunës për përfaqësimin e drejt dhe prezantimin me kohet të dëshmive, fakteve që mbështesin vendimin e menaxhmentit në këto raste. Në të kundërtën vendimet e organeve përkatëse duhet të respektohen duke mos lejuar shpenzimet shtesë apo pagesën e gjobave të shqiptuar që dëmtojnë parat e taksapaguesve.
16	Menaxhimi i pasurisë	Kryetari duhet të sigurojë se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë të bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 02/2013. Një komision i veçantë duhet të krijohet për të identifikuar boshllëqet e sistemit dhe për të siguruar se tërë pasuria është identifikuar dhe evidentuar në regjistrin e pasurisë.
17	Llogaritë e Arketueshme	Kryetari duhet të vendosë politika dhe mekanizma të tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke pasur si prioritet obligimet me vlerë më të lartë dhe duke i kushtuar kujdes vjetërsisë së borxhit. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj tatimpaguesve të cilët nuk i përmbushin obligimet tatimore.
18	Obligimet	Kryetari, duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara, të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF në përputhje me kërkesat ligjore.
19	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

---

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Letër e Konfirmimit




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Novobërdës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe koment i kemi diskutuar lidhur me përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z.Svetislav Ivanović

Kryetar i Komunës,

Data: 20.06.2019, Novobërdës,

